



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:217183
Datë: 20.02.2024
Numri i dokumentit: 05347204

Ac.nr.4457/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, me seli në Prishtinë, Rr. “Nëna Terezë”, nr.36, kundër debitorit Sh. (M.) Q., nga fshati Xërxë, Komuna Rahovec, për përmbartimin e kërkesës në të holla-pagesën e borxhit në shumë prej 2,378.97 €, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec, PPP.nr.100/19, të datës 23.11.2021, me datë 15.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e debitorit Sh. (M.) Q., nga fshati Xërxë, Komuna Rahovec, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec, PPP.nr.100/19, i datës 23.11.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është vendosur si në vijim REFUZOHET prapësimi i debitorit Sh. (M.) Q. nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, i paraqitur kundër urdhrorit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), lidhur me kthimin e borxhin në shumën prej 2.378,97 €. Urdhri i përmbartuesit privat Gj. R., P.nr.334/19, prej datës 25.06.2019, me të cilin është caktuar përmbartimi sipas propozimit të kreditorit, lidhur me kthimin e borxhit, në shumën prej 2.378,97 euro, me kamatë ligjore sipas mjeteve të afatizuara pa destinim të caktuar, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 25.06.2019, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, MBETËT NË FUQI. Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbartimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe dispozitave të LMD-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shlejeve thelbësore të dispozitave të LPP-së, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës që të nxjerrë aktvendim me të cilin do ta aprovojë prapësimin e debitorit, ta shfuqizojë urdhrin për përmbarim dhe ta refuzojë propozimin për përmbarim të kreditorit si të pabazuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e debitorit, është e pa pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori, më datë 25.06.2019, përmes përmbaruesit privat, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afariste, për pagesën e borxhit në emër të energjisë elektrike të shpenzuar nga debitori, për periudhën kohore nga data 26.10.2009 deri më datën 20.03.2013, në shumë totale prej 2,378.97 €, me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë, me detaje tjera si në propozimin për përmbarim. Përmbaruesi privat Gëzim Gjoshi, me Urdhrin P.nr.334/19, të datës 25.06.2019, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori ndaj këtij urdhri, me datë 30.07.2019 ka parashtruar prapësim duke i kundërshtuar pretendimet si në propozimin për përmbarim si të pa bazuara me arsyetimin se borxhi i faturuar është ngarkuar në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë e po ashtu ky borxh është parashkruar dhe për këto arsye i ka propozuar gjykatës që urdhrin për përmbarim ta anulojë.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke pretenduar se debitori me nënshkrimin e Kontratës për pagesën e borxhit si dhe me nënshkrimin e deklaratës mbi dakordimin e borxhit, *ex lege* ka shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së. Po ashtu, me të njëjtën përgjigje ka pretenduar se kërkesa për prapësim e debitorit, nuk është në harmoni me nenin 69 të LPP-së, për faktin se baza e prapësimit nuk është e mbështetur në prova të duhura.

Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin PPP.nr.100/19, ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe Urdhrin për lejimin e përmbarimit e ka lënë në fuqi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe i njëjti është refuzuar ngase në rastin konkret lidhur me pretendimin e debitorit, se ka parashkrim absolut, gjykata e muri si të pa bazuar sepse debitori me datën 02.09.2016 ka

nënshkruar kontratë për pagimin e borxhit dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-043 për faljen e Borxheve Publike dhe i njëjti nuk i është përmbajtur kësaj marrëveshje dhe gjykatës nuk i ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën si dhe debitori është thirrur në atë se i ka kryer të gjitha obligimet ndaj KEK-ut, si dhe pretendimet e debitorit se për të njëjtën shumë të kërkesës është tërhequr nga kërkesëpapia në procedurë kontestimore, nuk është e vërtetë sepse kjo është bërë në emër të kompensimit të dëmit e jo në emër të borxhit dhe se padia është bërë për njëhisor tjetër që ka shifër DGJ-9035493, ndërsa propozimi për përmbarim për shumën 2.378,97€ është bërë për shifrën DGJ-80010940.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 22 paragrafi 1, pika 1.1 dhe neni 73, paragrafi 1,2 dhe 3 të LPP-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë vlerëson se, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), m) dhe k) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas Gjykatës së Apelit vlerësohet se, në rastin konkret, pretendimet ankimore të debitorit për shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, janë të pa bazuara dhe njëkohësisht të pa qëndrueshme, nga se gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh të gjitha pretendimet ankimore të debitorit dhe ka nxjerrë aktvendimin e atakuar që është i qartë dhe i kuptueshëm, ashtu që dispozitivi është në përputhje me arsyetimin e dhënë dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit, në rastin konkret vlerëson se, pretendimet ankimore të debitorit se, gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, janë po ashtu të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret, ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, mbi bazën e provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ashtu që e njëjta ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve, ka çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, duke vërtetuar kështu faktet vendimtare në këtë çështje përmbarimore, ashtu që ka nxjerrë një pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes dhe mbi këtë bazë, ka marrë edhe aktvendimin e atakuar, duke vendosur drejtë si në dispozitivin e tij.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës dhe pas vërtetimit të plotë dhe real të gjendjes faktike, e njëjta ka bërë aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, ashtu që drejtë ka zbatuar dhe interpretuar dispozitat konkrete ligjore, të cilat zbatohen në situata të tilla sikurse kjo në rastin konkret. Në situatën konkrete gjykata e shkallës së parë, drejtë ka interpretuar dhe zbatuar dispozitat e nenit 368 të LMD-së në lidhje me parashkrimin e borxhit në fjalë.

Pretendimet ankimore të debitorit se propozimi për përmbarim është iniciuar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe LMD-së dhe se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar përmbarimi nuk ka titull ekzekutiv apo tipare të përmbarueshmërisë, nuk qëndrojnë ngase me nenin 21 të LPP-së, organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë ekstraktit nga librat afariste DGJ-80010940, ku kjo parashihet në nenin 29 par.1 të LPP-së, e ku ceket se *“përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij Ligji janë: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2 Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3 Faturat”*, të njëjtat përmbajnë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 29 par.3 të po këtij ligji, sipas të cilit parashihet se *“dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në pjesën kur ka vendosur se, në rastin konkret debitori me datë 02.09.2016 ka lidhur kontratë për pagimin e borxhit dhe ka nënshkruar deklaratën mbi dakordimin e borxhit me kreditorin, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-043 për faljen e Borxheve Publike dhe i njëjti nuk i është përmbajtur kësaj marrëveshjeje ngase në shkresa të lëndës vërehet se debitori me datë 02.09.2016 ka lidhur kontratë me kreditorin për pagesën e borxhit përmes së cilës është dakorduar se me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve i njëjti do të bëjë pagesat në 18 (tetëmbëdhjetë) këste për borxhin total nga Janari 2009 në shumë prej 131,23 € dhe në rast se debitori shkakton tri vonesa të një pas njëshme sipas programit, marrëveshja do të shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse ka do të fshihet ndërsa pjesa e mbetur e borxhit do të rikthehet. Në rastin konkret nga ekstrakti nga librat afariste të bashkangjitur krahas propozimit për përmbarim, konstatohet se debitori ka bërë vetëm tri pagesa të kësteve dhe atë në vlerë prej 22,00 € për secilin këst ashtu që i njëjti nuk i është përmbajtur marrëveshjes së nënshkruar me kreditorin.

Duke pasur parasysh, të thënat më lartë edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori është i detyruar që të kryejë obligimin e tij ndaj kreditorit, fillimisht për faktin se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 të Kontratës për pagesën e borxhit, ashtu që përcaktohet se: *“Në rast kur përfituesi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse ka fshihet, dhe pjesa e mbetur e borxhit i kthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”*. Pra, në rastin konkret debitori ka shkaktuar tri vonesa të njëpasnjëshme duke mos iu përmbajtur kontratës së lidhur me kreditorin, andaj tani vjen në shprehje zbatimi i nenit 3 të kontratës së lartpërmendur dhe pretendimi i tij ankimor se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës nuk qëndron e kjo pasi që me rastin e nënshkrimit të deklaratës mbi dakordimin e borxhit është shkaktuar ndërprerja e parashkrimit me datën 02.09.2016, ndërsa propozimi për përmbarim është bërë me datë 03.07.2019.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me pretendimet tjera ankimore, Gjykata e Apelit ka gjetur se të njëjtat janë të pa bazuara ngase me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjëherë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *” në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.4457/2023, më dt. 15.02.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v